

VENDIMMARRJA ËSHTË E JONA



NJERËZIT QË UDHËHEQJIN

EDI (11), RINESA (10), ERGYS (10), VALMIR (11), ALBIONA (10), ERZAN (10), FATLINDA (10),
KALTRINA (11)

Ne me shokët dhe shoqet e klasës kemi mësuar për demokracinë. Për gjërat që kemi mësuar sot në punëtorinë e demokracisë mund të lexoni në këtë artikull. Ju urojmë lexim të mbarë


Çfarë dimë ne për demokracinë është se ajo është një formë e udhëheqjes së një populli. Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke, sepse aty ka lindur demokracia. Demokracia ka lindur në Athinë të Greqisë në vitin 507 para erës sonë. Janë dy forma të demokracisë. Ato janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Në demokracinë e drejtpërdrejtë vendimet i merr i gjithë populli në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kurse, në demokracinë përfaqësuese qytetarët e vendit tonë votojnë për deputetët e Kuvendit të Kosovës. Ne qytetarët e vegjël posa t'i mbushim 18 vjet premtojmë se do të dalim të votojmë për të udhëhequr vendin tonë të dashur në mënyrë sa më demokratike.



Grupi i demokratëve të rinjë



Të gjithë kemi të drejtën për të zgjedhur



Parimet e demokracisë



Kuvendi, vendi ku punojnë deputetët tanë



Punimi i Fatlindës për Kushtetutën e Kosovës

PUSHTETI LEGJISLATIV

BLERON (11), ALKETA (11), ARLIND (10), KASTRIOT (11), IMER (10), ARZU (10), RINESA (11),

AULONA (10)

Demokracia dhe Kuvendi i Kosovës

Demokracia do të thotë liri dhe të drejta të barabarta për të gjithë. Një ndër institucionet më të rëndësishme në demokraci është Kuvendi.

Në demokracinë përfaqësuese me sistem parlamentar, populli në procesin zgjedhor voton kandidatët për deputet. Pra, deputetët janë përfaqësuesit e popullit. Në Kuvendin e Kosovës janë 120 deputetë, ku 100 prej tyre janë të kombit shqiptar dhe 20 janë të komuniteteve jo shumicë (romë, ashkali, egjiptian, serbë, boshnjakë dhe turq).

Funksionet e Kuvendit të Kosovës janë: funksioni përfaqësues, funksioni legjislativ dhe funksioni i kontrollit. Pra, në Kuvend punojnë deputetët të cilët përfaqësojnë popullin, si dhe miratohen ose nuk miratohen ligjet. Po ashtu, Kuvendi mbikëqyr Qeverinë.

Ligjet janë rregulla të cilat duhet të zbatohen. Propozimet në Kuvend mund t'i bëjnë: deputetët, Qeveria, Presidenti dhe populli.

Në Kuvend deputetët ndajnë punët e tyre, prandaj janë disa grupe punuese të cilat ndryshe quhen edhe komisione parlamentare. Disa nga këto komisione janë: Komisioni për Arsim, Komisioni për Buxhet, Komisioni për Shëndetësi etj.

Grupi ynë ka një mesazh për ju që e lexuat këtë artikull, të respektojmë njëri-tjetrin dhe t'i zbatojmë ligjet duke qenë qytetarë të përgjegjshëm.



Grupi i deputetëve të ardhshëm



Ligjet duhet të zbatohen

Miratton, shfugizon dhe Propozon ligjet

Mbykqyrë punën e Qeverisë

Zgjedh Qeverinë dhe Presidentin



Në këtë vizatim kemi paraqitur disa shokë dhe shoqe tona duke shkuar në shkollë. Në vendin tonë, e drejta e shkollimit është një e drejtë e cila është e respektuar dhe e dashur nga çdo qytetar



ZGJEDHJET LOKALE DHE ZGJEDHJET QENDRORE

AGRON (11), ENDRIT (11), ELSA (11), ELMEDINA (10), FJONA (11), KADRI (11), SAMI (11), SHEMSIE (11)

VESA (11)



Përfaqësuesit e Asamblesë Komunale janë të zgjedhur direkt nga populli, mandati i të cilëve është katër vjeçar

Pse janë të rëndësishme zgjedhjet?

Zgjedhjet janë ndër elementet më të rëndësishme të një shteti demokratik. Kjo sepse qytetarët janë ata të cilët zgjedhin përfaqësuesit e tyre me anë të votave. Zgjedhjet janë të pranishme në jetën e çdo qytetari dhe këtu bëjmë pjesë edhe ne si nxënës.

Në zgjedhjet e përditshme, zgjedhim diçka që na lehtëson jetën tonë ose diçka që neve na bën të ndihemi mirë. Por zgjedhjet që qytetarët votojnë për përfaqësuesit e tyre luajnë rol shumë të madh për shtetin tonë, por po ashtu edhe për ne si qytetarë të Kosovës. Në shtetin tonë, qytetarët votojnë për përfaqësuesit e tyre, në dy lloje të zgjedhjeve.

Ato janë: zgjedhjet lokale ku çdo qytetar mbi moshën 18 vjeçare përmes votës zgjedh përfaqësuesit e komunës, kryetarin e komunës si dhe asambleistët. Ndërsa, në zgjedhjet qendrore qytetarët votojnë për përfaqësuesit e tyre që janë deputetët. Nga kjo kuptojmë që zgjedhja e qytetarit ka shumë rëndësi, sepse vetëm për një votë mund të bëhet ndryshimi. Për të kuptuar më mirë dhe vërtetuar se një votë mund të bëjë ndryshim, ne votuam brenda grupit tonë për një punë që dikush nga nxënësit duhet ta bëjë. Pasi që grupi ynë përbëhej nga 9 nxënës njëri nga anëtarët e grupit në fillim nuk dëshironte që të votojë dhe ne mbetëm vetëm tetë. Çështja në të cilën

votuat ishte ndarja e roleve brenda grupit. Kur përfundoj votimi ndodhi diçka jo shumë e pritur nga ana jonë. Ishte numri i njëjtë i votave për dy nga anëtarët e grupit. Pastaj ajo çka menduam ishte që, nëse bindim edhe shokun tonë të votojë atëherë do të kemi një ndryshim. Votuat përsëri, por këtë herë dolëm më ndryshe, sepse një votë vendosi se cili nga anëtarët do të shkruajë e cili do të vizatojë. Pra, kjo luajti rol shumë të madh, sepse neve na bëri të kuptojmë më mirë rëndësinë e votave. Secili nga ne tani e dijmë se sa e rëndësishme është pjesëmarrja në zgjedhje.



Autorët e artikullit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Naim Frashëri“
Klasa: V/2
Vendi: Vushtrri